



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 606/18 prot.

Tiranë, më 19.9.2025

VENDIM
Nr.36, datë 19.9.2025

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 31, DATË 18.7.2025

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Zbatimin e Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 31, datë 18.7.2025, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprimet administrative të kryera gjatë procesit të ecurisë disiplinore, në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”*,

KONSTATOVA SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është regjistruar informacioni me shkresën nr. 606 prot., datë 12.6.2025, i dërguar nga nëpunësja Rudina Bollano, me detyrë *“Drejtore i Drejtorisë së Ekzaminimit”*, pranë institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, në të cilin ngrihen pretendimet e nëpunëses, për parregullsi të kryera në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore *“Vërejtje”*, në ngarkim të saj.

Me qëllim verifikimin e rastit, me marrjen e këtij informacioni, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, nëpërmjet shkresës nr. 606/2 prot., datë 19.6.2025 *“Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të ardhur nga nëpunësja Rudina Bollano, për dhënie mase disiplinore “Vërejtje”*”, ka vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të kësaj procedure disiplinore, si dhe ka kërkuar dokumentacionin në të cilën është materializuar ky proces.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ procesi është përmbyllur me vendimin nr. 31, datë 18.7.2025, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprimet administrative të kryera gjatë procesit të ecurisë disiplinore, në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, me shkresën nr. 2677/9 prot., datë 31.7.2025, *“Shkresë përcjellëse”*, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 606/16 prot., datë 31.7.2025, ka vënë në dispozicion të këtij të fundit dokumentacionin që materializon veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 31, datë 18.7.2025, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, materializuar në dokumentet shkresore përkatëse, vërej se situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin objekt i këtij verifikimi, paraqitet si më poshtë vijon:

Për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, ***në pikën 1***, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm, i institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, që në zbatim të nenit 108, 110 dhe 111, të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, nëpërmjet një akti të ri me shkrim, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 2375 prot., datë 5.6.2025, për dhënien e masës disiplinore *“Vërejtje”*, në ngarkim të nëpunëses Rudina Bollano dhe të rregullojë pasojat duke hequr aktin e masës disiplinore nga dosja e personelit të nëpunëses dhe nga Regjistri Qendror i Personelit.

Në lidhje me sa më sipër, konstatoj se, me aktin nr. 2677/8 prot., datë 31.7.2025, *“Akti administrativ Vendim për anulimin e aktit nr. 2375, datë 5.6.2025”*, Drejtori i Përgjithshëm, i institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale ka vendosur anulimin e aktit nr. 2375 prot., datë 5.6.2025.

Njëkohësisht, vërej se, në zbatim ***të pikës 2*** të vendimit paralajmërues, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë institucionit ka ndjekur me kujdes ecurinë e këtij procesi duke rregulluar pasojat dhe duke hequr aktin e masës disiplinore *“Vërejtje”* në ngarkim të kësaj nëpunëseje sipas kërkesave të vendimit paralajmërues 31/2025, të Komisionerit.

Nisur nga sa më sipër, *vlerësoj se*, nga ana e institucionit, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, janë kryer veprimet administrative të nevojshme për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Paralajmërues Nr.31, datë 18.7.2025, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së*

Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 (i ndryshuar), të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 31, datë 18.7.2025, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprimet administrative të kryera gjatë procesit të ecurisë disiplinore, në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, duke zbatuar detyrat e lëna të dispozitivit të Vendimit nr. 31, datë 18.7.2025.
3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, Departamentit të Administratës Publike dhe nëpunësja Rudina Bollano.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha